



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi-Hashani, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ardita Salihu dhe Mehmet Muçaj udhëheqës i ekipit, Enver Ramadani, Mimoza Morina-Kelani, Fjolla Bakalli-Sadiku dhe Riza Spanca anëtarë të ekipit, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	32
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për vitin 2019, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosjet janë të plota dhe të sakta.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në përgjithësi ka funksionuar, por janë identifikuar mangësi në disa fusha të cilat duhen të përmirësohen.

Ministria ka përgatitur planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve por zbatimi i tyre nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pa modifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministria është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënie të opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Çështje Tjera

Mostrat e përzgjedhura të shpenzimeve tek Policia e Kosovës për kategorinë Investime Kapitale në vlerë 10,937,823€, nuk i kemi audituar sepse këto shpenzime ndërlidhen me informata (dokumente) të klasifikuara që Policia e Kosovës i kishte klasifikuar në bazë të udhëzuesit të brendshëm.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MPB-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Ministria ka vendosur kontrolle në raport me obligimet statutores të saj, mirëpo moszbatimi me konsistencë i rregullave, ka shkaktuar mangësi në shumë procese. Fushat ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i të hyrave, pagave, mallrave dhe shërbimeve, investimeve kapitale dhe pasurive, detyrimeve kontingjente, të arkëtueshmëve etj.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimi mit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	124,158,194	133,394,200	128,689,455	96	113,198,085	117,486,461
Granti i Qeverisë - Buxheti	118,267,065	122,313,600	118,951,965	97	112,683,569	115,165,600
Te hyrat nga AKP	5,000,000	9,780,740	9,185,322	94	0	0
Të hyrat e bartura nga viti paraprak	0	391,129	0	0	0	179,544
Të hyrat vetjake	891,129	891,129	550,380	62	500,000	890,887
Donacionet e jashtme	0	17,602	1,788	10	14,516	1,250,430

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 9,236,006€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit të qeverisë në vlerë 4,046,535€, rritjes së të hyrave nga fondi AKP në vlerë 4,780,740€, donacioneve të jashtme në vlerë 17,602€, si dhe të hyrave të bartura në vlerë 391,129€.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në vitin 2019, ministria ka shpenzuar 128,689,455€ ose rreth 96% të buxhetit final.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	124,158,194	133,394,200	128,689,455	96	113,198,085	117,486,461
Pagat dhe Mëditjet	80,134,796	85,567,343	85,542,782	100	79,388,734	76,217,698
Mallrat dhe Shërbimet	23,358,194	24,764,917	23,456,350	95	22,056,241	26,468,081
Shërbimet komunale	2,006,800	1,699,000	1,308,440	77	1,270,436	1,462,301
Subvencionet dhe Transferet	2,031,367	1,802,063	950,627	53	1,989,392	5,137,971
Investimet Kapitale	16,627,037	19,560,877	17,431,256	89	8,493,282	8,200,410

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 5,432,547€, krahasuar me buxhetin fillestar. Rritja ishte bërë me vendim të Qeverisë nr. 12/115 të datës 17.12.2019 në shumë 2,052,000€, për pagesën e orëve të grumbulluara të cilat kishin rrjedhur nga viti 2018 dhe që ndërlidhën me punën të cilën policia e kishte bërë jashtë orarit të rregullt. Po ashtu, kishte rritje me vendim të Qeverisë 03/115 në vlerë 3,380,547€ të datës 17.12.2019 për kursime dhe ndarje buxhetore, për ta mbuluar deficitin në paga të Policia e Kosovës në fund të vitit 2019.

Buxheti final për mallra dhe shërbime krahas buxhetit fillestar ishte rritur për 1,406,723€. Kjo rritje ishte bërë:

- Me vendimin 02/113 të datës 05.11.2019, ishin ndarë 134,000€ dhe vendimin 03/115 të datës 17.12.2019, ishin ndarë 450,491€; si dhe
- Në pajtim me nenin 30 të LMFP-së, Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e ministrisë për transferin e mjeteve në vlerë 805,000 nga kategoritë tjera ekonomike në kategorinë mallra dhe shërbime si dhe kishte rritje nga donacionet e jashtme në vlerë 17,232€.

Buxheti final për komunalitë ishte zvogëluar për 307,800€. Zvogëlimi prej 203,000€ ishte bërë në pajtim me nenin 30.2 të LMFP-së ku Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e MPB-së për transferet buxhetore nga kjo kategori në kategorinë mallra dhe shërbime si dhe zvogëlimi për 104,800€ ishte bërë në bazë të vendimeve të Qeverisë për kursime dhe ndarje buxhetore.

Buxheti final për subvencione është zvogëluar për 229,304€ krahasuar me buxhetin fillestar. Ndryshimi ishte rezultat i vendimit të Qeverisë me nr. 03/115 të datës 17.12.2019 për kursime dhe ndarje buxhetore ku buxheti ishte zvogëluar për 620,803€. Po ashtu kishte rritje të buxhetit nga bartja e të hyrave vetjake në Policinë e Kosovës në shumë 391,129€ si dhe bartja e një donacioni të jashtëm në shumë 370€.

Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 2,933,840€ në krahasim me buxhetin fillestar. Rritja e buxhetit është bërë me vendim të Qeverisë nr. 02/113 për kursime dhe ndarje buxhetore të datës 05.11.2019 ku ishin ndarë 4,480,740€. Po ashtu me vendim të Qeverisë 03/115 të datës 17.12.2019 për kursime dhe ndarje buxhetore ishin bërë kursime buxhetore prej 1,114,900€. Më tutje, zvogëlimi prej 432,000€, ishte bërë në pajtim me nenin 30.2 të LMFPF ku Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e MPB-së për transfere buxhetore nga kjo kategori në kategorinë mallra dhe shërbime.

2.1.1 Të hyrat

MPB për vitin 2019 kishte realizuar të hyra në vlerë prej 62,209,192€, që krahasuar me vitin paraprak (55,919,738€) kishte një rritje prej 6,289,454€. Ministra me ligj të buxhetit i ka pasur të buxhetuara me të drejtë shpenzimi të hyrat vetjake në vlerë 891,129€, Rritja e të hyrave ishte si rezultat i rritjes së gjobave të trafikut, rritjes së të hyrave nga taksat për dokumente të udhëtimit dhe rritjes së të hyrave nga taksat tjera.

Të hyrat realizohen nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksat për dokumente të udhëtimit, gjobat në trafik dhe taksat tjera. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 249,136€ dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë dhe nuk kemi hasur në parregullsi.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetjake	52,000,000	52,000,000	62,209,192	55,919,738	49,184,900
Totali	52,000,000	52,000,000	62,209,192	55,919,738	49,184,900

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2019, ishte 85,567,343€, prej tyre ishin shpenzuar 85,542,782€. Numri i lejuar i të punësuarve sipas ligjit të buxhetit ishte 10,868 punëtor ndërsa në fund të vitit ministria kishte 10,630 punëtorë. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 114,481€, dhe 26 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A1 - Shpallje e konkursit në mospajtim me katalogun e vendeve të punës**Gjetja**

Katalogu i vendeve të punës në shërbimin civil i nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike (MAP) në vitin 2015, dhe i ndryshuar në vitin 2018 me "Titujt e vendeve të punës të plotësuar dhe ndryshuar në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës", përcaktojnë kualifikimin dhe përvojën e duhur për pozita të caktuara të punës. Sipas këtij katalogu për pozitën "Zyrtar për buxhet dhe financa 1", për kriter të kualifikimit kërkohet diplomë universitare ose shkollim i lartë.

AME kishte shpallur konkursin në kundërshtim me kriteret e katalogut të vendeve të punës dhe në kundërshtim me aprovimin e kërkesës nga MAP. Për pozitën e shpallur "Zyrtar për buxhet dhe financa 1" tek kriteret e kualifikimit dhe shkathtësive është kërkuar diplomë universitare apo arsimim i mesëm dhe jo siç është përcaktuar me katalog diplomë universitare ose shkollim i lartë. Si rrjedhojë në këtë pozitë është punësuar kandidati me shkollim të mesëm.

Kjo ka ndodhur nga papërgjegjësia e zyrtarëve përgjegjës në AME për t'i respektuar kriteret e kërkuara nga katalogu i vendeve të punës në shërbimin civil dhe të aprovuara nga MAP.

Më tutje, neni 29 i Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil përcakton: Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil duhet të përgatis një listë të shkurtër prej së paku tre kandidatëve dhe nëse paneli nuk identifikon së paku tre kandidatë adekuat për përfshirjen në listën e shkurtër pozita duhet të rishpallet.

Komisioni përzgjedhës i rekrutimit nuk kishte përgatitur listën e ngushtë të kandidatëve për të vendosur poentimin sipas kriterëve të konkursit.

Shkaku i mos hartimit të listës së ngushtë ishte papërgjegjësia e komisionit përzgjedhës për të hartuar këtë dokument.

Ndikimi

Vendosja e kriterëve të konkursit në mospërputhje me kriteret katalogut të vendeve të punës të aprovuar nga MAP si dhe mungesa e listës së ngushtë ku shihet poentimi i kandidatëve, ka ndikuar në vendosjen e kriterëve favorizuese, punësim jo meritore dhe pa kompetencë profesionale.

Rekomandimi A1

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së duhet të siguroj se çdo pozitë e shpallur për rekrutim është në përputhje me katalogun e pozitave të punës të aprovuar nga MAP. Po ashtu të siguroj se komisioni përzgjedhës me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të punësimit të hartoj dokumentet siç kërkohet me rregullativën ligjore që të sigurohet punësim në bazë të meritës dhe nevojave të punës.

Çështja A2 - Punësimi i kandidatit pa i plotësuar kriteret

Gjetja Në konkursin e shpallur për pozitën e punës “Vozitës” në AME te kriteri i përvojës së punës është kërkuar së paku një vit përvojë pune si shofer. Neni 6 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik përcakton se konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kriteret e parapara me konkurs.

Për këtë pozitë kishin aplikuar katër kandidatë të cilët nuk kishin ofruar fare të dëshmi për përvojën e punës. Pavarësisht mosplotësimit të këtij kriteri, AME nuk e kishte anuluar konkursin dhe si rezultat njëri kandidat ishte punësuar. Për më tepër, dosja e rekrutimit nuk ishte e kompletuar pasi që mungonte lista e aplikantëve që i plotësojnë kushtet dhe kriteret (lista e ngushtë), e cila duhet të përpilohet nga Komisioni Përzgjedhës.

Kjo ka ndodhur për shkak të papërgjegjësisë së komisionit përzgjedhës për të bërë vlerësimin e kandidatëve në pajtim me kriteret e përcaktuara dhe për të hartuar listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret.

Ndikimi Shpërfillja e kërkesave të konkursit dhe mos hartimi i listës së ngushtë mund të rezultojë në rekrutimin e personave jo adekuat për vendin e shpallur të punës.

Rekomandimi A2 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së të siguroj se në të ardhmen komisioni përzgjedhës i rekrutimit do të respektoj kërkesat e akteve që e rregullojnë themelimin e marrëdhënies së punës dhe kriteret e konkursit.

Çështja B1 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara

Gjetja Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 02/2018 për rregullimin e marrëdhënies së punës në Policinë e Kosovës (PK), përkatësisht neni 39 paragrafi 3 përcakton se: me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë secili zyrtar i Policisë mund të caktohet në një vend të punës apo transferohet prej një vendi në vendin tjetër të punës nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për atë vend të punës, pa marrë parasysh nivelin, pozitën apo gradën. Udhëzimi Administrativ nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor përcakton kriteret që duhet t’i plotësoj secili Zyrtari Policor për pjesëmarrje në gradim dhe procesin e testimit që duhet t’i nënshtrohet për të marrë gradën e caktuar.

Struktura organizative e Policisë së Kosovës përcakton gradën e kërkuar për secilën pozitë të punës.

Ne kemi vërejtur se përkundër një përmirësimi nga viti paraparak, një numër i stafit policor ende është sistemuar në pozita të punës pa e plotësuar kriterin e gradës që e kërkon ajo pozitë sipas strukturës organizative. Sipas të dhënave nga njësia e personelit, 198 zyrtarë policor vazhdojnë të mbeten të sistemuar në pozita ku kërkohet gradë më e lartë se sa grada që aktualisht e kishin arritur të punësuarit përmes procesit të rregullt të gradimit. Vlen të theksohet se PK në vitin 2019, kishte kryer disa procese të gradimit për reduktim të numrit të punësuarve që ushtrojnë pozita me grada më të larta por deri më tani këto procese janë të pamjaftueshme për respektimin e plotë të kriteve të sistematizimit në vendet e punës sipas gradës përkatëse.

Ndikimi Sistemimi i stafit në pozita që nuk janë në përputhje me gradën adekuate mund të ndikoj që pozitat e punës të ushtrohen nga persona me mungesë të kompetencës profesionale.

Rekomandimi B1 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalit

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2019 ishte 26,463,917€, prej tyre ishin shpenzuar 24,764,790€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, furnizim me targa, furnizim me veshmbathje, karburant për vetura, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, mirëmbajtja e sistemit të letërnjoftimeve, pasaportave dhe patentë shoferëve, furnizim me ushqim dhe pije, sigurimin e ndërtesave etj.

Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 10,177,436€ si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A3 - Prezantim jo i drejtë i shpenzimeve në pasqyrat financiare

- Gjetja** Neni 13 dhe 14 i Rregullores MF 01/2017 për Raportim Vjetor të Organizatave Buxhetore kërkon që organizatat buxhetore ta paraqesin totalin e saktë të pagesave.
- MPB në nenin 13 dhe 14 të PFV-ve kishte raportuar shpenzime në shumë prej 128,701,000€ ndërsa sipas SIMFK shpenzimet për vitin 2019 ishin 128,689,455€. Pra ekziston një mbivlerësim i shpenzimeve për 11,545€. Për më shumë, totali i pranimeve dhe pagesave i raportuar te neni 13 i PFV nuk barazohet për 2,000€.
- Zyrtarët e MPB-së konfirmojnë që shuma e shpenzimeve në momentin e përgatitjes së PFV ka qenë e saktë dhe në harmoni me shënimet e SIMFK, por më vonë pasur ndryshim të shënimeve në SIMFK nga Thesari dhe pa dijeninë e Ministrisë.
- Ndikimi** Prezantimi i gabuar i shpenzimeve ndikon që përdoruesit e pasqyrave financiare të mos marrin informata të sakta për shpenzimet të cilat ishin realizuar gjatë vitit.
- Rekomandimi A3** Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet prezantohen saktë në pasqyrat financiare sipas të dhënave të SIMFK-së dhe kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

Çështja A4 -Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë

Gjetja

Ligji nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, neni 22, parasheh se “Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag a dhe do të lejojë devijim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%) pa marrë parasysh datën origjinale të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Akademia Kosovës për Siguri Publike (AKSP) me 14.11.2016 kishte lidhur kontratë publike kornizë për 36 muaj për “Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së” në vlerë totale indikative prej 557,225€. Ne kemi identifikuar se AKSP kishte përmbushur kontratën në muajin maj të vitit 2019. Realizimi i kontratës në total ishte 735,832€, duke shfrytëzuar edhe mospërputhjen e lejuar plus 30% dhe duke e tejkeluar mbi pragun e lejuar për 11,440€. Më tutje, AKSP kishte zhvilluar një aktivitet emergjent të prokurimit duke aplikuar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kontraktimi ishte bërë me OE me të cilin kishte skaduar kontrata paraprake dhe vlera e kontratës së negociuar ishte 206,393€. Kontrata është lidhur me 13.06.2019 dhe zgjat deri në përfundim të aktivitetit të rregullt të paraparë në Planin e Prokurimit.

Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së pa-planifikuar të numrit të shfrytëzuesve të shujtave ditore përkatësisht rritjes së numrit të studentëve kadet (430 kadetë) të Policisë së Kosovës (PK). Për ta tejkeluar këtë situatë të krijuar dhe në mënyrë që furnizimi me ushqim të mos ndalet ata kanë aplikuar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Ndikimi

Tejkalimi i kontratës kornizë mbi normën e lejuar mund të ndikoj që organizata buxhetore të hyjë obligime financiare të paplanifikuara dhe ka rezultuar që aktiviteti të bëhet në kundërshtim me kornizën rregullative.

Rekomandimi A4 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë, në rastet kur planifikohet të bëhet rekrutimi i kadetëve të rijnë duhet të koordinohen mes veti në mënyrë që përgatitjet operative dhe ato financiare të kryhen me kohë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,802,063€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 950,627€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me përkrahje financiare me qëllim të ri-integrimit të personave të riadhesuar. Kemi testuar 8 mostra për teste substanciale në vlerë 120,720€ si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A5 - Shpërndarja e subvencioneve për personelin e Ministrisë

Gjetja Ligji nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë, neni 20 kompensimi i pagës, përcakton: nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit.

Ministri me vendim (vendimi nr.383/të datës.28.12.2018) kishte vendos t'i ndaj nga 100€ për person si mirënjohje për punëtorët e dalluar për kontributin e dhënë në përmbushjen e objektivave të Ministrisë. Përmes këtij vendimi ishin shpërblyer 15 punonjës të shërbimit civil nga kategoria Subvencione dhe Transfere.

Kjo ka ndodh për shkak të mos përfilljes së kërkesave ligjore nga menaxhmenti i ministrisë.

Ndikimi Kompensimi me para i punonjësve jashtë sistemit të pagave ndikon në rritjen e shpenzimeve të ministrisë dhe shmang pagesën e kontributeve dhe tatimeve të obliguara me ligj.

Rekomandimi A5 Ministri të siguroj se kompensimet e stafit bëhen vetëm në rastet e parapara me ligjin e pagave dhe të ndërpres praktikat e tilla të shpërblimeve pa bazë ligjore. Për më tepër, mjetet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të ndahen sipas destinimit për të cilin janë alokuar dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 19,560,877€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 17,431,256€. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me pagesat për ndërtesat administrative, pajisje të teknologjisë informative dhe blerje e pajisjeve tjera. Kemi testuar 62 mostra për teste substanciale në vlerë 4,120,911€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6- Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve

Gjetja Udhëzimi Administrativ 2005/08 për Klasifikimi Ekonomik të Shpenzimeve, përcakton se blerjet me vlerë mbi 1,000€ dhe nëse kanë afat të përdorimit më tepër se një vit klasifikohen si shpenzime kapitale. Ndërsa pajisjet në vlerë të vogël se 1,000€ edhe nëse kanë afat përdorimi prej më tepër se një vit ato përfshihen në definicionin e mallrave dhe shërbimeve.

Policia Kosovës me datën 05.12.2019 kishte lidhur kontratë për "Furnizim me pjesë dhe pajisje për IT në vlerë 52,612€. Gjatë testimit kemi vërejtur që pagesa me vlerë 10,997€, ishte bërë nga kategoria ekonomike Investime Kapitale derisa artikujt e blerë i takojnë kategorisë ekonomike Mallra dhe Shërbime. Artikujt të cilët ishin faturuar dhe paguar me këtë faturë kanë vlerë më të vogël se 1,000€.

Kjo kishte ndodhur si rrjedhojë e planifikimi të buxhetit të gabuar ngase projekti furnizim me pjesë dhe pajisje për IT ishte buxhetuar në tabelën e investimeve kapitale.

Ndikimi Planifikimi i projekteve buxhetore në kategoritë ekonomike jo adekuate ndikon që ekzekutimit i pagesave dhe regjistrimi i shpenzimeve të klasifikohet në kategori jo adekuate dhe si rrjedhojë e kësaj ndikon në RVF që të mbivlerësohen investimet kapitale dhe nën vlerësohen mallrat dhe shërbimet.

Rekomandimi A6 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të buxhetit, shpenzimet të planifikohen në kategorinë adekuate ekonomike sipas planit kontabël.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Raportin Vjetor Financiar (RVF) e pasurive kapitale është 48,003,805€, e pasurive jokapitale është 3,381,729€ si dhe e stokeve 3,605,759€. Kemi testuar 75 mostra për testim substancial në vlerë 4,885,240€. Në aspektin e pajtueshmërisë kemi vlerësuar nëse ministria ka vepruar në pajtim me kërkesat e rregullores për pasuri. Çështjet që kanë rezultuar nga auditimi janë të përshkruar më poshtë.

Çështja A7 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 11 paragrafi 3 përcakton se: pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Nga testimet tona kemi evidentuar dy³ projekte në vlerë totale 58,803€, të cilat edhe pse kishin përfunduar ato ende mbaheshin si investime në vijim, pra nuk ishin bartur tek klasa përkatëse (përdorim) dhe nuk kishte filluar përlllogaritja e zhvlerësimit të tyre.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së komunikimit të menaxherëve të kontratave me zyrtarin e pasurisë i cili është përgjegjës për evidentim dhe regjistrim të pasurive.

Ndikimi Mbajtja e projekteve të përfunduara si investime në vijim, ndikon në mbivlerësim të pasurive për shkak të mos zbritjes së zhvlerësimit duke ofruar informata çorientuese për shfrytëzuesit e raportit financiar.

Rekomandimi A7 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AME-së duhet të sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, duke i regjistruar të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores.

³ Renovimi i depos së AME-së në shumë 40,489€ kishte përfunduar në vitin 2018 ndërsa Renovim i Objektivit të QRA-QPD Skenderaj në shumë 18,314€ kishte përfunduar në vitin 2019.

Çështja A8 Prezantim jo i plotë i pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve

Gjetja Neni 19.3.2-Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€ dhe neni 19.3.3 Stoqet i RVF kërkon që pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet të prezantohen në vlera të plota dhe të sakta.

Nga testimet tona kemi gjetur se Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) nuk kishte qenë në gjendje të gjenerojë shënimet e pasurive nën 1,000€ në fund të vitit dhe për këtë arsye pasuritë e AME-së nën 1,000€ nuk ishin raportuar fare në RVF e vitit 2019.

Po ashtu kemi identifikuar se vlera e stoqeve prej 3,605,759€ e raportuar në RVF nuk është e saktë për faktin se stoqet e depove ndihmëse të MPB-së dhe AME-së nuk ishin raportuar në RVF.

Arsyeja e mos paraqitjes së pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve ishte problemet teknike me sistemin e E-Pasurisë, sistem ky i cili menaxhohet dhe administrohet nga MAP.

Ndikimi Mungesa e evidencave të plota lidhur me vlerën e pasurive nën 1000€ dhe stoqeve ndikon që shifrat aktuale të prezantuara në RVF lidhur me këto kategori të pasurive të jenë të nënvlerësuara.

Rekomandimi A8 Ministri në bashkëpunim Drejtorin e AME-së përmes MAP-it të siguroj funksionalizimin dhe monitorimin e sistemit të e-pasurisë në mënyrë që të gjenerohen informata të sakta për pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet dhe të njëjtat të prezantohen në RVF.

2.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Pasqyra e avanceve të hapura të prezantuara në RVF në fund të vitit 2019 ishte 79,895€. Çështjet lidhur me avance janë shpalosur si në vijim:

Çështja B2 - Avancet e pa mbyllura

Gjetja

Në bazë të rregullës financiare nr.01/2013 MF-shpenzimi i parave publike dhe UA për udhëtime zyrtare nr. MShP 2004/7, avancet për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

MPB kishte paraqitur në RVF avance të hapura në vlerë prej 79,895€, prej të cilave 10,288€, ishin avance që i takojnë vitit 2019 dhe 69,607€ kishin të bënin me avance të bartura që nga viti 2010.

Dy avance të vitit 2019, për udhëtime zyrtare të Policisë së Kosovës në vlerë 7,788€, nuk ishin mbyllur për shkak se dy zyrtarë policor kishin shkuar në udhëtim zyrtar në fund të muajit dhjetor 2019 dhe pas kthimit ishin mbyllur në vitin 2020. Ndërsa avanci tjetër i vitit 2019, në vlerë prej 2,500€ para e gatshme që ndërlihdhet me AKSP nuk ishte mbyllur për shkak të një gabimi teknik gjatë procesit të mbylljes. Megjithatë, përkundër kërkesës së AKSP për korrigjim të shpenzimit, Thesari nuk kishte bërë korrigjimin.

Sa i përket avanceve të bartura nga vitet 2010 në vlerë 69,607€, sipas zyrtarëve të MPB-së figurojnë si të hapura në MF por entiteti akoma nuk ka arritur t'i identifikoj se për cilat avance bëhet fjalë, dhe sipas të dhënave të MPB, të gjitha avancet figurojnë të mbyllura. MPB kishte mbajtur takime me Thesarin e Kosovës për t'i identifikuar këto avance mirëpo deri më tani nuk kanë pasur sukses.

Ndikimi

Mosmbyllja e avanceve prezanton gabimin në llogarinë e avanceve dhe si rezultat kjo llogari figuron e hapur në vazhdimësi.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ta sqaroj çështjen e avanceve të hapura, të trashëguara nga vitet e mëparshme dhe të siguroj se një problem i tillë nuk do të shfaqet në të ardhmen. Për këtë qëllim duhet të ngritet një komision i përbashkët në identifikimin dhe në mbylljen e tyre.

2.4 Të arkëtueshmet

MPB në Raportin Vjetor Financiar (RVF) të vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 7,790,088€. Krahasuar me vitin paraprak vlera e llogarive të arkëtueshme është më e lartë për 777,139€. Shumica dërmuese e llogarive të arkëtueshme ishin nga gjobat e Policisë (7,697,871€). Nga lista e këtyre llogarive, ne kemi përzgjedhur 33 mostra në vlerë 74,243€ dhe testimi ka rezultuar me çështjen e paraqitur në vijim:

Çështja B3 - Regjistrimi jo i saktë i llogarive të arkëtueshme (LLA)

Gjetja Neni 17 i Raportit Vjetor Financiar kërkon që llogaritë e arkëtueshme të prezantohen drejtë dhe saktë.

Ne kemi identifikuar se në 10 raste Policia e Kosovës në pajtim me ligjet në fuqi kishte lëshuar fletëparaqitje për kundërvajtje (pa e precizuar vlerën financiare të gjobës) duke i proceduar në Gjykatë. Për këto 10 raste sistemi informativ i policisë kishte përlllogaritur vlerën financiare në shumë 15,100€, të cilat ishin të raportuara në RVF. Këto gjoba nuk është dashur të raportohen në RVF si llogari të arkëtueshme pasi kanë kaluar nën menaxhimin e gjykatave. Sipas zyrtarëve shkaku i ndodhjes se kësaj dukurie është se në momentin e lëshimit të tiketës nga policia për gjykatë sistemi në mënyrë automatike e llogaritë shumën financiare.

Për më shumë, kemi identifikuar 4 raste ku vlerat e gjobave të shqiptuara ishin 770€, ndërsa në regjistrin e gjobave për rastet e njëjta vlerat ishin raportuar si llogari e arkëtueshme në shumë 17,400€. Kjo ka ardhur si pasojë e futjes së gabueshme të informatave në sistemin elektronik.

Ndikimi Regjistrimi në sistem i fletëparaqitjeve të cilat kanë kaluar në gjykata si dhe gabimet e bëra në regjistrimin e llogarive të arkëtueshme kanë ndikuar që LLA të mos jenë të sakta dhe të njëjtat të prezantohen në mënyrë të gabuar në RVF.

Rekomandimi B3 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që Ll/A të prezantohen drejtë në RVF.

2.5 Detyrimet

2.5.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 ishte 97,131€. Detyrimet e pa paguara më shumë se 30 ditë ishin 811€, ndërsa ato më pak se 30 ditë 96,320€. Këto detyrime përbëhen nga: mallra dhe shërbime 90,382€, komunal 1,450€ dhe subvencione 5,068€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Ndërsa për obligime kontraktuale MPB nuk ka arritur të hartoj një regjistër të obligimeve të cilat priten të realizohen në vitet vijuese.

2.5.2 Detyrimet Kontingjente

Detyrimet kontingjente në fund të vitit 2019 janë 1,162,901€ dhe ato ndërlidhën kryesisht me pretendimet e palëve lidhur me disa kontrata që kishte pasur entiteti vite më parë dhe për te cilat është në procese gjyqësore.

Çështja A9 Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 18 i Rregullores MF - Nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore kërkon që të raportojnë detyrimet kontingjente.

MPB kishte raportuar në RVF detyrime kontingjente 1,162,901€. Kjo vlerë e raportuar nuk ishte e saktë për shkak se në RVF ishte përfshirë një padi (pretendim) e MPB-së ndaj një Operatori Ekonomik në vlerë 203,066€. Pra kjo, nuk ka të bëjë me detyrim kontingjent por me pasuri kontingjente për shkak se ministria pret ta fitoj kontestin dhe të gjeneroj të hyra nga kjo padi. Kjo kishte ndodhur për shkak të paqartësisë rreth kontesteve gjyqësore ngase sipas tyre njëherë MPB ka qenë palë e paditur ndërsa në rastin e fundit është në cilësinë e paditësit dhe kjo ka shkaktuar paqartësi dhe është raportuar si detyrim kontingjent.

Ndikimi Shpalosja vlerave të tilla në RVF përveç që nuk është e saktë ndikon që shfrytëzuesit e RVF të keq informohen lidhur me detyrimet kontingjente.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të plota dhe të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

MPB dhe Agjencitë e pavarura në kuadër të saj (PK, IPK dhe AKSP), kanë të themeluar Njësitë e Auditimit të Brendshëm (NjAB-të) të cilat operojnë me: MPB (4 auditor), PK (3 auditor), AKSP (1 auditor) dhe IPK (1 auditor). Secila njësi kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit të bazuar në vlerësim të rrezikut dhe prioritetëve ndërsa fushëveprimi i auditimeve të kryera përfshinte kryesisht vitin 2019.

Këto njësi të auditimit në vitin 2019 kishin planifikuar dhe realizuar 30 raporte të auditimit si dhe kishin raportuar në baza gjashte mujore në NJQH për Auditim Brendshëm.

MPB me 18.03.2019 kishte themeluar KA i cili kishte funksionuar deri në muajin tetor të vitit 2019. Ky komitet gjatë kësaj periudhe kishte arritur të mbaj dy takime të rregullta dhe pastaj njëri nga anëtarët kishte dhënë dorëheqje. Me 03.10.2019 MPB kishte themeluar Komitetin e ri të Auditimit i cili kishte arritur të mbaj dy takime një për vitin 2019 dhe një takim në janar 2020.

Çështja A10 -Përbërja e komiteti të auditimit jo në pajtim me ligjin

Gjetja Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike Komiteti i Auditimit përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë, ku dy të tretat (2/3) janë të jashtëm nga fusha përkatëse e auditimit, ndërsa pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik.

Ne kemi identifikuar se të gjithë anëtarët e Komitetit të ri të Auditimit ishin punonjës ministrisë. Kjo ka ndodh nga pakujdesia e menaxhmentit për të emëruar anëtarët e komitetit në pajtim me kërkesat ligjore.

Ndikimi Emërimi i të gjithë anëtarëve nga vetë entiteti për Komitet të Auditimit mund të ndikoj që KA të mos siguroj pavarësinë e punës dhe mbështetjen e duhur për auditorët e brendshëm.

Rekomandimi A10 Ministri duhet të siguroj që përbërja e Komitetit të Auditimit të jetë në harmoni me kërkesat ligjore me qëllim që KA të mund të mbulojë përgjegjësitë e veta në mënyrë të pavarur.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të MPB-së ka rezultuar me 13 rekomandime. MPB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Ndërsa nuk kishte hartuar dhe dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 3 rekomandime janë zbatuar, 4 nuk janë adresuar ende, 6 janë të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Çështja A 11- Mos caktimi i zyrtarit përgjegjës kontaktues sipas rregullores dhe mos dorëzimi i raporteve të progresit mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA

Gjetja Neni 14 paragrafi 4 i Rregullores së Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit parasheh: Pas hartimit të Planit të Veprimit, entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy herë në vit, respektivisht deri me 30 shtator dhe 15 mars. Po ashtu paragrafi 7 i nenit 14 të rregullores parasheh: Kreu i entitetit të audituar, do të caktoj një zyrtar përgjegjës kontaktues për komunikim me Zyrën Kombëtare të Auditimit lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit.

Ministra nuk kishte hartuar raportet lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve pavarësisht kërkesave tona drejtuar ministrisë për dorëzimin e tyre. Po ashtu ministra nuk ka caktuar ndonjë zyrtar përgjegjës kontaktues për komunikim me Zyrën Kombëtare të Auditimit lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit. Kjo ka ndodhur nga neglizhenca e menaxhmentit për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë.

Ndikimi Mos hartimi i raporteve nga menaxhmenti i ministrisë lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve dhe mos caktimi i zyrtarit sipas kërkesës së rregullores mund të ndikoj që menaxhmenti i ministrisë mos të ketë njohuri në lidhje me progresin e adresimit të rekomandimeve të dhëna nga ZKA me ç' rast rekomandimet të mbesin të pazbatuara.

Rekomandimi A11 Ministri të siguroj se do ta caktoj një zyrtar përgjegjës ashtu siç kërkohet me rregullore dhe do të hartoj raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Pas hartimit të këtyre raporteve t'i dërgoj në ZKA dhe Kuvend.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
C1	PFV	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe udhëheqësit e agjencive tjera në kuadër të ministrisë, duhet të rris përgjegjësinë tek stafi përgjegjës, në lidhje me dobësitë që kanë shkaktuar theksimin e çështjes. Në këtë drejtim, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë dhe detyrimet kontingjente janë evidentuar dhe shpalosur saktë në pasqyra financiare. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe të realizohen në kategorinë adekuate ekonomike me qëllim të prezantimit të drejtë të tyre në PFV.	MPB kishte azhurnuar regjistrin e pasurisë kapitale duke bërë regjistrimin e pasurive kapitale të identifikuar në raportin e vitit 2018. Edhe në vitin 2019 kemi hasur gabime në prezantimin e detyrimeve kontingjente dhe pagesave të bëra nga kodet e gabuara.	Rekomandim i mbyllur.
B1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të ndërmarrin një vlerësim sistematik të arsyeve për mos-realizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ultë të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuar duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i projekteve kapitale dhe buxhetit të përmirësohet.	Në planin e veprimit ishte planifikuar që rekomandimi do të zbatohet në vitin 2019, kështu që niveli i realizimit të buxhetit ishte përmirësuar në raport me vitin e kaluar (89% realizimi i buxhetit për investime kapitale).	Rekomandim mbyllur.
B2	Menaxhimi i personelit-Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara.	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policorë në pozita të lira bëhet pas plotësimit të kriterëve apo rekrutimit të rregullt brenda PK dhe kompensimi i të punësuarve të bëhet në përputhje me gradat dhe sistemin aktual të aprovuar të pagave.	PK kishte zhvilluar disa procese të gradimit gjatë vitit 2019 por ende nuk kishte arritur të adresoj në tërësi rekomandimin e vitit paraprake pasi që gjendja e ngjajshme është	Rekomandim i pa zbatuar.

			identifikuar edhe në vitin 2019.	
B3	Marrëveshje për shërbime të veçanta në pozitë e rregullta dhe afat më të gjatë se sa lejohet me ligj.	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e përgjithshëm të AME-së duhet t'i shqyrtojë arsyet pse rastet e tilla kanë ndodhur, dhe të ndërpresin praktikën e angazhimit të përkohshëm të stafit për pozitë e rregullta. Në rast të nevojave për shërbime të veçanta, ato duhet të sigurohen duke ju nënshtruar kërkesave dhe procedurave ligjore.	AME kishte 11 raste të tilla që janë bartur nga viti paraprak por që të gjitha janë ndërprerë gjatë vitit. Derisa MPB, përkatësisht ARC kishte 59 raste të punësuarve në këtë formë por që të gjitha ishin ndërprerë deri në përfundim të vitit.	Rekomandim i zbatuar.
A1	Mangësi në procedurën e angazhimit me marrëveshje për shërbime të veçanta.	Drejtori i Përgjithshëm i AME-së duhet të sigurojë që në rast të nevojës për të angazhuar staf për kohë të shkurtër, do të respektohen të gjitha procedurat ligjore, duke përfshirë edhe vlerësimin korrekt dhe të bazuar të kandidatëve nga komisioni rekrutues.	Pas skadimit të kontratave me shërbime të veçanta ato nuk janë vazhduar.	Rekomandim i zbatuar.
A2	Mallra dhe Shërbime-Mungesë e deklaratës me shkrim për tenderin me çmime jo-normalisht të ulë	Krye shefi Ekzekutiv i IPK-së të sigurohet që çdo kontratë të nënshkruhet pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e kërkuara me LPP dhe rregulloret plotësuese. Në rastin e ofertave me çmime jo-normalisht të ulëta, të shqyrtohet besueshmëria e tenderëve dhe të kërkohen sqarimet e nevojshme nga komisioni vlerësues i ofertave para se të procedohet me hapat e mëtejshëm.	Gjatë testimit të procedurave të prokurimit nuk kemi identifikuar probleme të natyrës së tillë.	Rekomandim i mbyllur.
B4	Çështjet e Përbashkëta - Mangësi në procedimin e pagesave	Ministri duhet të sigurojë se zyrtarët financiar zbatojnë me konsistencë procedurat e shpenzimeve sipas hapave të përcaktuar me rregulloren e shpenzimeve për paratë publike, dhe rastet e tilla të mos përsëriten.	Vazhdon ende kjo dukuri në procedimin e pagesave. E Trajtuar në letërmënaxhment pasi që është me prioritet të ulët.	Rekomandim i pa zbatuar.
B5	Pasuritë Kapitale dhe jo kapitale - Menaxhimi i	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes aktuale në flotën e	Çështjet e ngritura në vitin e kaluar janë adresuar sepse Policia e Kosovës	Rekomandim i mbyllur.

	flotës së automjeteve.	automjeteve për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e procesit të servisimit të automjeteve.	kishte larguar nga regjistri disa nga veturat e identifikuara dhe të cilat ishin në listën e pritjes për servisim. Megjithatë, ende ka vetura që janë në listën e pritjes për servisim. Për më shumë PK kishte bërë një vlerësim të gjendjes dhe kishte bërë tjetërsimin e 313 veturave, çka në fakt e ka bërë vlerësimin e gjendjes aktuale.	
B6	Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurisë dhe procesin e inventarizimit	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AME-së duhet të sigurojnë që e gjithë pasuria me vlerë nën 1,000€, të regjistrohet në e-pasuria, si dhe të bëhet inventarizimi i pasurisë dhe të harmonizohen raportet e inventarizimit me regjistrat e pasurive para së të përgatiten PFV e vitit 2019.	Edhe në vitin 2019 kemi vërejtur se regjistri i pasurive nën 1,000€ nuk është i plotë. Këtë e kemi vërejtur përmes testeve të auditimit.	Rekomandim i mbyllur.
B7	Trajtimi i parasë së gatshme-Avancet e hapura.	Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të merr të gjitha masat që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ta sqaroj çështjen e avanceve të hapura, të trashëguara nga vitet e mëparshme dhe të siguroj se problemi i tillë nuk do të shfaqet në të ardhmen.	Në planin e veprimit është potencuar që do të adresohet në vitin 2019 por ende gjendja vazhdon të jetë e njëjtë si vitin e kaluar.	Rekomandim i pa zbatuar.
A3	Llogaritë e Arkëtueshmë-Regjistrimi jo i saktë i shumës së gjobave	Drejtori i përgjithshëm i PK-së duhet të siguroj që regjistrimi i dënimeve mandatore në sistemin elektronik të bëhet në bazë të shumave që janë shqiptuar në dënime, në mënyrë që informatat lidhur me këto llogari të jenë të sakta dhe si të tilla, të raportohen në PFV.	Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme kemi vërejtur se probleme të natyrës së ngjashme kishte edhe në vitin 2019.	Rekomandim i pa zbatuar.
A4	Auditimi Brendshëm-Mos përmbushja	Drejtori i AKSP-së duhet të sigurojë që pozita e mbetur e lirë të plotësohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.	AB në AKSP kishte përmbushur planin vjetor të auditimit.	Rekomandim i zbatuar.

	planit vjetor auditimit AKSP			
B8	Dobësi në menaxhimin e rrezikut	Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës janë duke i përmbushur të gjitha obligimet në lidhje me menaxhimin e rrezikut, përfshirë këtu edhe vendosjen e mekanizmave adekuat të rishikimit dhe raportimit për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	MPB dhe njësitë vartëse kishin listën e rreziqeve me përjashtim të AME-së.	Rekomandim i mbyllur.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Shpallje konkursit jo ne harmoni me katalogun e vende të punës	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së duhet të siguroj se çdo pozitë e shpallur për rekrutim është në përputhje me katalogun e pozitave të punës të aprovuar nga MAP. Po ashtu të siguroj se komisioni përzgjedhës me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të punësimit të hartoj dokumentet siç kërkohet me rregullativën ligjore që të sigurohet punësim në bazë të meritës dhe nevojave të punës.		
A2	Punësimi i kandidatit pa i plotësuar kriteret	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së të siguroj se në të ardhmen komisioni përzgjedhës i rekrutimit do të respektoj kërkesat e akteve që e rregullojnë themelimin e marrëdhënies së punës dhe kriteret e konkursit.		
B1	Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.		
A3	Prezantim jo i drejtë i shpenzimeve në pasqyrat financiare	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet prezantohen saktë në pasqyrat financiare sipas të dhënave të SIMFK-së dhe kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.		
A4	Tejkalim i vlerës së kontratës kornizë	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë, në rastet kur planifikohet të bëhet rekrutimi i kadetëve të rijnë duhet të koordinohen mes veti në mënyrë që përgatitjet operative dhe ato financiare të kryhen me kohë.		

A5	Shpërndarja e subvencioneve ndaj stafit të Ministrisë	Ministri të siguroj se kompensimet e stafit bëhen vetëm në rastet e parapara me ligjin e pagave dhe të ndërpres praktikat e tilla të shpërblimeve pa bazë ligjore. Për më tepër, mjetet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të ndahen sipas destinimit për të cilin janë alokuar dhe në pajtim me kërkesat ligjore.
A6	Keq klasifikim i gabuar i shpenzimeve	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të buxhetit, shpenzimet të planifikohen në kategorinë adekuate ekonomike sipas planit kontabël.
A7	Dobësi në menaxhimin e pasurisë	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AME-së duhet të sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, duke i regjistruar të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores.
A8	Prezantim jo i plotë i pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AME-së përmes MAP-it të siguroj funksionalizimin dhe monitorimin e sistemit të e-pasurisë në mënyrë që të gjenerohen informata të sakta për pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet dhe të njëjtat të prezantohen në RVF.
B2	Avancet e pa mbyllura	Ministri duhet të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ta sqaroj çështjen e avanceve të hapura, të trashëguara nga vitet e mëparshme dhe të siguroj se një problem i tillë nuk do të shfaqet në të ardhmen. Për këtë qëllim duhet të ngritët një komision i përbashkët në identifikimin dhe në mbylljen e tyre.
B3	Regjistrimi jo i saktë i llogarive të arkëtueshme	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që LI/A të prezantohen drejtë në RVF.
A9	Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të plota dhe të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.
A10	Funksionimi i komitetit të auditimit	Ministri duhet të siguroj që përbërja e Komitetit të Auditimit të jetë në harmoni me kërkesat ligjore me qëllim që KA të mund të mbulojë përgjegjësitë e veta në mënyrë të pavarur.

A11	Mos caktimi i zyrtarit përgjegjës kontaktues sipas rregullores dhe mos hartim dhe dorëzimi i raporteve të progresit mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA	Ministri të siguroj se do ta caktoj një zyrtar përgjegjës ashtu siç kërkohet me rregullore dhe do të hartoj raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Pas hartimit të këtyre raporteve t'i dërgoj në ZKA dhe Kuvend.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

ZYRA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM/ KANCELARIA STALNOG SEKRETARA
OFFICE OF THE SECRETARY GENERAL

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Lulzim Ejupi

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme

16 korrik 2020, Prishtinë

Faqe 1 nga 1